

## ROMA VERSITAS ALBANIA KA NISUR ZBATIMIN E PROJEKTIT:

### ARSIM, PUNËSIM, PARTNERITET, DHE BARAZI GJINORE: NJË FORMULË E SUKSESSHME PËR ROMËT NË EDUKIM DHE FORMIM PROFESIONAL

#### Projekti shtrihet në disa qytete të Shqipërisë dhe mbështet këto kategori:

- Të rinjtë Rom (mosha 14-18) të cilët kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm dhe janë tashmë të regjistruar në shkollë profesionale.
- Të rinjtë Rom (mosha 14-18) të cilët kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm dhe duan të vazhdojnë arsimin profesional.
- Të rinjtë më të rritur (mosha 18-28), të cilët nuk e kanë përfunduar arsimin e mesëm ose profesional dhe duan ta përfundojnë.
- Të rinjtë më të rritur (mosha 18-28) të cilët duan të përfundojnë arsimimin profesional, ose kërkojnë mundësi më të mira arsimimi dhe punësimi profesional.
- Të rinjtë në kërkim të punës (18-28), të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm profesional, dhe dëshirojnë që të ndryshojnë profilin e punës dhe janë në kërkim të aftësive më të mira profesionale.

#### Projekti bazohet në dy shtylla kryesore: Arsimimi profesional, dhe Punësimi.

#### Aktivitetet në kuadër të arsimimit

- ✓ Përzgjedhja dhe mbështetja me bursë financiare në masën 40 dhe 80 euro sipas kategorisë.
- ✓ Mbështetja me mësim shtesë dhe këshilla praktike, (leksione suplementare dhe mentorime për të rinjtë Rom për t'i lehtësuar gjetjen e një profesioni të certifikuar.
- ✓ Zhvillimi i të rinjve bazuar tek nevojat individuale dhe planet e zhvillimit personal dhe profesional.

#### Aktivitetet në kuadër të punësimit

- Organizimi i takimeve dhe lidhja e partneritetit me kompanitë.
- Organizimi i kurseve për zhvillimin e aftësive të buta.
- Mbështetja me tre (3) muaj punësim të paguar nga projekti.



Në kuadër të #WinforVET kandidatët e përzgjedhur do të përfitojnë

 Mbështetje Financiare

 Mbështetje në Punësim

 Partneritet me Kompanitë


 Zhvillim Profesional

 Mentorime dhe Tutorime


Projekti “Arsim, Punësim, Partneritet dhe Barazi Gjinore: Një Formulë e Suksesshme për Romët në Arsim dhe Formim”, zbatohet nga Roma Education Fund (REF), Roma Versitas Kosovo (RVK) dhe Roma Versitas Albania (RVA) dhe financohet nga Austrian Development Cooperation

## Personeli i projektit WinforVET ka realizuar disa aktivitete në kuadër të zbatimit të projektit #WinforVET

Së pari, ka realizuar shpërndarjen e informacionit rreth aplikimit nëpërmjet disa kanaleve të komunikimit si, platforma e mediatorëve komunitar, rrjeteve sociale, organizatat të cilat punojnë me Romët dhe rrjetit ALUMNI.



Aplikimi nga të rinjtë Roma është kryer online, ku një mbështetje të madhe kanë ofruar organizatat lokale të cilat kanë lehtësuar me shpërndarjen e informacionit dhe lehtësimin në aplikim.




Gjithashtu, personeli zbatues ka realizuar takime me aplikantë potencial në disa nga qytetet e targetuara për zbatimin e projektit, ku përveç informimit të të rinjve është ofruar edhe lehtësim për të plotësuar aplikimin.

Pjesa më e madhe e aplikimeve janë nga djemtë, duke vënë në dukje mungesën e drejtpeshimit ndërmjet vajzave dhe djemve nga minoriteti Rom. Mbetet sfida përfshirja e vajzave Rome në arsim, dhe nxitjen profesionale.

Megjithatë, projekti parashikon përparësi në nxitjen dhe përfshirjen e vajzave në komponentët e projektit #WinforVET.

Ndërsa, pjesa më e madhe e aplikimeve kanë ardhur nga të rinjtë të shkollave të mesme profesionale, duke u ndjekur në vend të dytë nga të rinjtë të cilët kanë përfunduar arsimin e ulët. Gjatë vizitave në terren, është vënë re se personat me arsim të ulët nuk zotërojnë ndonjë profesion të caktuar, dhe punojnë në tregun informal të punësimit, ose në punë sezonale.



Projekti “Arsim, Punësim, Partneritet dhe Barazi Gjinore: Një Formulë e Suksesshme për Romët në Arsim dhe Formim”, zbatohet nga Roma Education Fund (REF), Roma Versitas Kosovo (RVK) dhe Roma Versitas Albania (RVA) dhe financohet nga Austrian Development Cooperation